



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 07.07.2025
Numër Protokollit: 4537/2025

A.nr.842/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtar, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.842/2025 të datës 06.05.2025, të parashtruar nga ankuesja, B.Sh, kundër organit të punësimit/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike -“*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.07.2025 mori:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.8422025, të datës 06.05.2025, të parashtruar nga ankuesja B.Sh.

A r s y e t i m

Ankuesja, B.Sh (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), me datë 06.05.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3038/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.842/2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference **RN00016973**, të shpallur sipas Konkursit publik të datës 07.03.2025, nga Ministria e Financave, Punës dhe transfereve Grupi i arkiv-dokumentacionit për pozitën e punës “Zyrtar për administrimin e dokumenteve”, klasa e pozitës Profesional 2, numri i kërkuar 1..

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se, Ministria e Financave , Punës dhe Transfereve më datë 07.03.2025 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00016973, Grupi i arkiv-dokumentacionit për pozitën e punës “Zyrtar për administrimin e dokumenteve”, klasa e pozitës Profesional 2, numri i kërkuar 1.. ku afati për aplikim ka qenë nga data 08.03.2025 deri më 06.04.2025.

Tutje sipas provave materiale të çështjes del se në konkursin përkatës ka aplikuar edhe ankuesja, mirëpo me Njoftimin e datës 18.04.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve , rezulton se e njëjta nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, me arsyetimin se Diploma e arsimit të lartë e nivelit të parë Bachelor e cila nuk i përket Grupit të arkiv-dokumentacionit sipas Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për klasifikimin e vendeve të Punës në Shërbimin Civil, të kërkuar sipas kriterëve të përgjithshme të konkursit.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve , më datë 07.05.2025, ka publikuar Njoftimin , nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë me më së shumti pikë për pozitën është shpallur A.O. me gjithësejt 84.8 pikë.

Ankuesja, pas publikimit të njoftimit përfundimtar për kandidatin e suksesshëm ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar Njoftimin e datës 18.04.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për refuzimin e aplikacionit.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati D.K, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016973, më datë 13.05.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.869/2025, të datës 24.06.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00016973 Grupi i arkiv-dokumentacionit për pozitën e punës “Zyrtar për administrimin e dokumenteve”, klasa e pozitës Profesional 2, si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.842/2025, të datës 06.05.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.869/2025, të datës 24.06.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN0001973, si një qëllim i propozuar edhe nga ankuesja në petitumin e ankesës atëherë mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”. Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.809/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.842/2025, të datës 06.05.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.842/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses; B.Sh.*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*